

Ac.nr.2738/2013

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Qerim Ademaj, kryetar i kolegjit, Ramë Hyseni dhe Fejzullah Rexhepi, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit H.Sh. nga fshati ... Komuna e Lipjani, të cilin e përfaqëson Z.A. avokat në Lipjan, sipas autorizimit, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve „ S ” me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson F.M. avokat në Prishtinë sipas autorizimit, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur sipas ankesës së të autorizuarit të te paditurës e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Lipjan , C.nr.207/10 i datës 17.06.2013, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 25.11.2016, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të autorizuarit te të paditurës Kompania e Sigurimeve „ S ” me seli në Prishtinë, dhe aktgjykimi Gjykatës Komunale në Lipjan, C-nr. 207/10 i datës 17.06.2013 VERTETOHET.

### A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar, C.nr.207/10 i datës 17.06.2013, më pikën I të dispozitivit pjesërisht e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e precizuar të paditësit H.Sh. nga fshati ... Komuna e Lipjanit, ku detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve „ S” me seli në Prishtinë qe paditësit t’ia kompensoj dëmin e pësuar në aksidentin e datës 23.05.2010 si vijon:

Në emër të dëmit jo material-moral:

-për dhimbjet fizike shumë prej 800 euro

-për frikën shumë prej 500 euro

Për dëmin material:

-për ushqim të përforcuar shumë prej 60 euro

E të gjitha këto detyrohet e paditura qe t’ia paguaj më kamatë siç e paguajnë bankat për mjetet e deponuara në bankë ne kohëzgjatje më shumë se një vit pa destimin të caktuar, nga data 06.06.2013 kur është bërë ekspertiza mjekësore mbi shkallën dhe llojin e lëndimeve, e deri në pagesën definitive , si dhe shpenzimet e procedurës civile ne shumë prej 455.28 euro, të gjitha në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e nën kërcenim të përmbarimit më dhunë.

Ndërsa më pikën II të dispozitivit është refuzuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë mbi shumat e gjykuara dhe atë për dhimbje fizike mbi shumë prej 800-2000 euro, për frikën mbi shumë prej 500-1500 euro, për rehabilitimin klimatik shumë prej 350 euro dhe për dëmin material në veturë shumë prej 700 euro, si e pa bazuar.

Kundër këtij aktgjykimi i autorizuari i të paditurës në afat ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës që ankesën si të tillë ta aprovojë, aktgjykimin e atakuar ta prishë dhe lëndën t'ia kthejë të në rigjykim dhe rivendosje gjykatës së shkallës së parë.

I autorizuari i paditësit në përgjigjen në ankesë, e ka kundërshtuar në tërësi si të pa bazuar ankesën e ushtruar nga i autorizuari i të paditurës, me propozimin bërë gjykatës së shkallës së dytë që e njëjta të refuzohet në tërësi si e pa bazuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës si gjykatë e instancës së shkallës së dytë, pas ekzaminimit të aktgjykimin të ankimuar në kuptim të dispozitës së nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të autorizuarit të të paditurës është e pathemeltë

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurës, të cilën e ka precizuar për se fundi herë i autorizuari i tij me parashtrësën e datës 13.06.2013, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material i cili i është shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të ndodhur më datë 23.05.2010 në Prishtinë, t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 4.610,00 euro, më kamatë ligjore si dhe të obligohet edhe ne pagesën e shpenzimeve të procedurës kontestimore.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor në të cilën sipas propozimit të palëve ka nxjerrë dhe administruar provat nga shkresat e lëndës, më vlerësimin e të cilave ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht si e bazuar, ku edhe ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, C.nr.207/10 i datës 17.06.2013, me të cilën vendos me decidivishtë si në dispozitiv të te njëjtit, ashtu siç Gjykata e Apelit e Kosovës e përshkroi më lartë ne pasusin e parë të arsytimit të këtij aktgjykimi.

Lidhur më mënyrën e vendosjes sipas aktgjykimin të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka arsytuar se gjatë shqyrtimit kryesor pa dyshim është vërtetuar se aksidenti kishte ndodhur më datë 23.05.2010 rreth orës 14:15 minuta ne Rr „ Agim Ramadani ‘’ fakt ky i vërtetuar nga raporti policor i aksidentit, ndërsa sa i përket lëndimeve që paditësi kishte pësuar në këtë aksident të ndodhur, ky fakt është vërtetuar nga raporti i Qendrës Emergjente ne dokumentacionin përcjellës, me çka mbi bazën e këtyre fakteve të vërtetuara për gjykatën e shkallës së parë është bërë e besueshme baza e kërkesëpadisë së paditësit.

Gjykata e shkallës së parë lidhur më lartësinë e dëmit të cilin e ka pësuar paditësi në aksidentin e ndodhur , ka arsytuar se kjo është vërtetuar përmes nxjerrjes se provës më ekspertim mjekësor nga lëmi i ortopedisë-traumatologjisë dhe psikiatrisë, ku ekspertët e lëmvive përkatëse pas shqyrtimit të dokumentacionit mjekësor nga shkresat e lëndës dhe ekzaminimit të drejtpërdrejtë që i kanë bërë paditësit, kanë konstatuar se paditësi kishte pësuar përdredhje të unazave të qafës dhe kokë dhimbje posttraumatike, të cilat konsiderohen lëndime të natyrës se lehtë trupore.

Paditësi dhimbje të intensitetit të lartë ka pasur për 24 orë për çka edhe është lajmëruar ne QKMF në Lipjan ku i ishte ordinuar terapia analgjeticke dhe sipas nevojës të lajmërohet

edhe në Qendrën Emergjente në çdo kohë, dhimbje të intensitetit të mesëm kishte pasur për 10 ditë dhe dhimbjet e intensitetit të ulët janë te pranishme të paditësi kohë pas kohe sidomos gjatë ndryshimeve klimatike. Ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 10 ditë, i pasur me minerale, vitamina, albumina etj. Terapia dhe rehabilitimi ka qenë i nevojshëm për 10 ditë ne ndonjë qendër rehabilituese. Frika sekondare të intensitet të lartë tek paditësi është shoqëruar me simptome të ankthit dhe çrregullim të gjumit si dhe rikujtim të ngjarjes që kanë zgjatur për 4-5 ditë dhe kjo frikë ka kaluar në frikë të intensitetit më të ulët e cila e ka shoqëruar më ndryshime intelektuale te karakterit ankiciozë më rënie te vullnetit dhe të disponimit si dhe frikë dhe pasiguri për pjesëmarrje ne komunikacion që kanë zgjatur për 2-3 javë.

Gjykata lidhur me lartësinë e kompensimit të dëmit material dhe jo material të gjykuar në pjesën aprovuese të kërkesëpadisë , vendimin e saj e ka mbështetur ne dispozitat ligjore te nenit 154, 178, 185 dhe 195 të LMD-së, vendimin mbi kamatën e ka bazuar ne dispozitën e nenit 277 të LMD-së, ndërsa vendimin mbi shpenzimet e procedurës e ka mbështetur ne dispozitën ligjore të nenit 452.1 dhe 453.1 të LPK-së, e duke pasur parasysh suksesin e palëve ne procedurën e udhëhequr.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g),( j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe drejtë është aplikuar e drejta materiale, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Gjendja faktike rezulton te jetë vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë te drejtë nga gjykata e shkallës së parë, e cila lidhur më mënyrën e vendosjes sipas aktgjykimit të ankimuar edhe ka dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes sipas të njëjtit aktgjykim, e cila gjendje faktike edhe sipas gjykatës ankimore ka mbështetje ne provat nga shkresat e lëndës dhe ne ligj.

Pretendimi ankimor i të paditurës se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë më shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së, më arsyetimin se dispozitivi i aktgjykimit është i paqartë dhe në kundërshtim më arsyetimin, përkatësisht arsyetimi i të njëjtit nuk jep arsye të mjaftueshme për vendosje si ne dispozitiv, sipas mendimit të Gjykatës së Apelit është i paqëndrueshëm për faktin se kjo gjykatë vlerëson se dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë dhe i përshtatshëm për përmbarrim, e në përputhje të plotë edhe me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë, ku në lidhshmëri me këtë edhe ka arsyetuar qartë mënyrën se si janë vërtetuar faktet dhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar, të cilat janë të pranueshme edhe për këtë gjykatë.

Të pathemelta janë edhe pretendimet e të paditurës për gjendjen faktike, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes lidhur më çështjen kontestuese në fjalë, nga gjykata e shkallës së parë janë provuar me prova përkatëse të cilat janë administruar ne procedurën kontestimore të udhëhequr tek gjykata e shkallës së parë. Për më tepër pretendimi i të paditurës se eksperti i psikiatrisë në shqyrtimin kryesor të mbajtur ka jap mendimin e tij pa u bazuar në asnjë provë mjekësore më të cilën do të vërtetohej se paditësi është kuruar të ndonjë psikiatër, duke u bazuar vetëm ne prova të

vjetra mjekësore dhe paragjykime, sipas kësaj gjykate është tërësisht i pathemeltë për faktin se kjo gjykatë konsideron se pa marrë parasysh se paditësi pas aksidentit të ndodhur nuk është kuruar te ndonjë mjek psikiatër, me ekzaminimin e drejtpërdrejtë fizik që në seancë nga eksperti psikiatër i është bërë paditësit, ka rezultuar se i njëjti si pasojë e aksidentit të ndodhur ka pësuar frikë sekondare të intensitetit të lartë, të ulët dhe të intensitetit edhe më të ulët në kohëzgjatjen e cila me detajishtë është përshkruar në mendimin e dhënë nga ana e ekspertit psikiatër, me çka sipas kësaj gjykate fakti se paditësi nuk ka kërkuar me herët ndihmë mjekësore tek eksperti i lëmit të psikiatrisë ka qenë pa relevancë për vendosje ndryshe nga ana e gjykatës së shkallës së parë, pasi që eksperti psikiatër gjatë shqyrtimit kryesor në mendimin e tij të dhënë qartë ka konstatuar se paditësi me rastin e aksidentit të ndodhur ka pësuar edhe këtë lloji të dëmit jo material.

Sa i përket të drejtës materiale lidhur me përgjegjësinë e të paditurës që e njëjta t'ia kompensojë paditësit dëmin material dhe jo material të shkaktuar të cilin e ka pësuar në aksidentin e komunikacionit, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë drejtë ka aplikuar të drejtën materiale, kur ka vendosur që e paditura është përgjegjëse për kompensimin e dëmit sipas dispozitës së nenit 154,178, 185 dhe 195 të LMD-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se në kuptim të dispozitave materialo-juridike të cilave u është referuar gjykata e shkallës së parë e në përputhje me gjendjen faktike, duke marrë në konsideratë natyrën e lëndimeve të lehta të cilat i ka pësuar paditësi, e duke marrë për bazë edhe rrethanat tjera që ndikojnë në përcaktimin e lartësisë së kompensimit si natyra e dhimbjeve fizike, lloji dhe intensiteti i frikës dhe rrethanat tjera, rezulton se shumata e gjykuara janë në përputhje me qëllimin e kompensimit. Gjykata e shkallës së parë duke vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar, ka vendosur në mënyrë të ekuilibruar në mes të shumave të gjykuara dhe natyrës së lëndimeve përkatësisht dëmit që ka pësuar paditësi, duke siguruar që kompensimi i gjykuar të jetë satisfaksion për paditësin, duke shmangur qëllimet tjera materiale (lukrative) që mund të bien ndesh me qëllimin e satisfaksionit në raste të tilla.

Pretendimi tjetër ankimor i të paditurit që i referohet shpenzimeve të procedurës kontestimore, sipas kësaj gjykate gjithashtu del të jetë i pabazuar pasi që e paditura si palë e cila ka humbur kontestin gjyqësor në kuptim të nenit 452.1 të LPK-së, ka për detyrim që paditësit si gjyfituese të ja shpërblejë shpenzimet gjyqësore, ku shpenzimet e njohura paditësit nga gjykata e shkallës së parë me shikimin në shkresat e lëndës rezulton se janë në përputhje të plotë me shpenzimet e nevojshme që paditësi ka pasur gjatë procedurës për ndjekjen e çështjes në gjyq, e që i referohen shpenzimeve lidhur me përfaqësimin e paditësit në procedurë nga i autorizuari i tij, taksave gjyqësore për padi dhe aktgjykim, si dhe nxjerrjen e provave me ekspertim nga lëmi mjekësor.

Nga arsyet e cekura më lartë Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr. 2738/2013, me datë 25.11.2016

Kryetari i kolegjit  
Qerim Ademaj, d.v